

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Ragip Namani dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.Q., nga Prizreni, kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 2502/2014, të datës 08.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit A.Q., nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2502/2014, i datës 08.11.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2502/2014, të datës 08.11.2016, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit A.Q., nga Prizreni, me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë, nr. A.02/422/2014, i datës 17.11.2014, si e pabazuar.

Kundër aktgjyqimit të lartpërmendur paditësi A.Q., nga Prizreni, ka parashtruar ankesë përmes të autorizuar të tij av. N.Q., nga Prizreni, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovoi si të bazuar dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që “ta aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit të anulohen vendimet të paditurës Prokuroria e Shtetit - Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit KD nr.01/14 i datës 25.06.2014, vendimi i komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave i Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit KA.nr.08/2014 të datës 21.08.2014 si dhe vendimi i Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.02/422/2014 i datës 17.11.2014 si të kundërligjshëm. Të obligohet e paditura e parë që paditësin A.Q. ta kthej në vendin e punës përkthyes në Prokurorin Themelore në Prishtinë duke ia kompensuar të ardhurat personale nga data 23.06.2014 deri në ditën e kthimit në punë”. Ose aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ kundër vendimit të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës me nr. A.02/422/2014, të datës 17.11.2014, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm. Ngase i është refuzuar ankesa si e pabazuar, ndërsa ka mbeten në fuqi vendimi nr.943/2014 i datës 22.08.2014, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, duke u bazuar në provat dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, gjënë së vendimi kontestues, është i drejt dhe i bazuar në ligj. Andaj duke u bazuar në provat e administruara, gjykata e shkallës së parë vendosi që ta refuzoj padinë e paditësit, dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, iu ka referuar dispozitave të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe atë të nenit 59 par.1 dhe 2, i cili përcakton se, 1. Nënpunësit Civil janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e Institucionit punëdhënës nënpunësit civil janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara. 2. Nënpunësit Civil janë të detyruar ti informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mos informimi ose mungesa e palajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisja e vendit të punës dhe denohet në përputhje me ligjin”. Ndërsa Rregullorja me nr. 04/2011 për Procedurat Disciplinore në Shërbimin Civil në nenin 6 par.13 përcakton se “ Mos informimi dhe mungesa e paarsyeshme për dy ditë pune të një pas njëshme është shkelje e rëndë serioze”. Ndërsa, gjykata ka vërejtë se paditësi ka munguar nga puna pa arsyetim nga data 18.06.2014 deri me datën 20.06.2014, duke mos arsyetuar mungesën nga puna. Sipas nenit 15 të Rregullorës 06/2011 për pushimet e shërbyesve civil përcaktohet se “Pushimi pa pagesë mund të autorizohet në raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i Insitucionit punëdhënës siç vijim: 1.1. Për ngritje profesionale për nevojat e vet nënpunësit civil 1.2 Për kujdesjen e anëtarit të ngushtë të familjes për shkak të sëmundjes (bashkëshortit, bashkëshortes, prindërit, fëmijës, motrës dhe vllaut), 1.3 Për kandidim për zgjedjet Komunale dhe Qendrore, 1.4 Për transferim të përkohshëm në detyrat tjera brenda ose

jashtë Kosove, 1.5 Për marrjen e detyrës së funksionit publik dhe 1.6 Për kryerjen e obligimeve ushtrake. Andaj, duke u bazuar në këto dispozita të lartcekura, pretendimet ankimore së aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje të së drejtes material dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sipas vlerësimit të këtij kolegji janë të pa bazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale. Pastaj së aktgjykimi është i pa qartë, i pa kuptueshëm, dispozitivi i aktgjykimit nuk mund të ekzaminohet, është kundërtë në vetveten dhe me pjesë të arsyetimit, dhe është jo i plotë. Këto pretendime nuk qëndrojnë, me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurit në përgjigje në padi pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pabazuara, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore së aktgjykimi është i pa qartë dhe i pa kuptueshëm, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsyet e nevojshme mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj konsideron se nuk ka shkelje të dispozitave materiale, siç pretendon paditësi.

Ndërsa sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse paditësi me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, pretendimet ankimore, se dispozita e nenit 89 par.1 pika 1.1. e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës në asnjë rast nuk përcakton në mënyrë eksplicite se nuk lejohet pushimi pa pagesë tek rastet kur personi ka obligime sipas vendimeve gjyqësore të lajmërohet për vuajtjet e dënimit dhe në këtë rast për derisa nuk ka qenë e ndaluar me ligj, kërkesa e paditësit është dashtë të aprovohet dhe ti mundësohet paditësit vuajtja e dënimit pa pasoja, ky kolegji nuk i aprovoi, ngase me dispozitat e lartcekura janë përcaktuar në mënyrë shpërhimorë - decitive rastet për të cilat mund të lejohet pushimi pa pagesë. Andaj kolegji vlerëson se pretendimet ankimore janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.A.nr.63/2017, me datë 23.02.2017

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi